



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REKTORATI

Nr 447 Prot.

Gjirokastër, më 07/05/2020

VENDIM

Nr. 06, datë 07.05.2020

PËR

PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR EDHE NË AUDITORE NË UNIVERSITETIN  
"EQREM ÇABEJ"

Mbështetur në ligjin 80/2018 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 40 pika 4; statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" nen 31, rregulloren e e Universitetit "Eqrem Çabej" nenet 19, 20, 21; urdhërin e ministres së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 104, datë 30.04.2020 "Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e Arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID-19", Rektorati në mbledhjen e tij të datës 07.05.2020 diskutoi për masat që duhen marrë për fillimin e procesit mësimor edhe në auditore dhe

VENDOSI:

1. Krahas zhvillimit të procesit mësimor online të merren të gjitha masat për fillimin e procesit mësimor edhe në auditore.
2. Njësitë kryesore të hartojnë rregulloret përkatëse ku të përcaktohen të gjitha aspektet që lidhen me zhvillimin e mësimin në auditor, duke respektuar me rigirozitet të gjitha standartet që lidhen me distancimin fizik dhe higjeno-sanitar.
3. Rregulloret e miratuara në dekanate të përcillen në Rektorat.
4. Njësitë kryesore të përcaktojnë afatet kohore për zhvillimin e procesit mesimor, të provimeve dhe mbrojtjes së diplomës,
  - a. për studentët që diplomohen
  - b. për studentët e viteve të para dhe të dyta
  - c. për provimet e vjeshtës
  - d. për diplomimin e studetëve të prapambetur pas sezonit të vjeshtës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Bektash MEMA

